



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilimnol/Predatao Received/ Delivered	03 - 03 2021	1	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHUK	953/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.68/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti - kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci – Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbaitëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.68/2021 të parashtruar me datë 08.02.2021 nga ankuesi me adresë „Rruga “Rasim Kiçina”, Nr.55 Skenderaj, kundër Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të themeluar nga Qeveria e Kosovës në çështjen juridike “Pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i inicuar përmes ankesës A.nr.68/2021 të datës 08.02.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, i emëruar me Vendimin numër prot.2230/2019 të datës 05.02.2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar, me Vendimin me nr.0007 të datës 11.01.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë është pezulluar nga detyra deri në përfundimin e procedurës disiplinore.

Ankuesi me datë 08.02.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 549/2021 të regjistruar me A.nr. 68/2021, Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit për pezullim nga detyra me numër 0007 të datës 11.01.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 22/02/2021 i ka drejtuar kërkesën për përgjigje në ankesë Komisionit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë..., i cili komision është përgjigjur më datë 26/02/2021 dhe poashtu ka bashkangjitur dokumentacion përcjellës të potencuar përmes kësaj shkrese që lidhen me lëndën konkrete dhe që janë objekt të administrimit të mëposhtëm.

Me qëllim të vërtetimit të bazës ligjore dhe konstatimit saktë të gjendjes faktike kolegji ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.68/2021 me Nr.Prot:549/2021 të datës 08.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë nr. Protokolli 2367 i datës 31.12.2020; Vendimi i datës 11.01.2021; Vendimi i datës 31.12.2020; Njoftimi nr. Ref.303/2020 i datës

31.12.2020; Përgjigje ne ankesë e datës 26.02.2021 E-mail; Shkresë njoftuese e datës 14.05.2014; Akt emërim i datës 28.02.2014; E-mail i datës 10.06.2019; E-mail i datës 02.08.2019; Vendimi në lidhje me strukturën organizative i datës 17.05.2014; Mendim juridik i Avokatit të Popullit i datës 09.07.2020; Raporti i Kallxo.com i datë 12.09.2020; Njoftim i ATK-së i datës 10.09.2019; E-mail i datë 10.07.2019; E-mail i datës 16.09.2019; E-mail i datës 17.09.2019; E-mail i datës 11.10.2019; Njoftim i datë 23.10.2019 për pezullim të konkurseve të publikuara të datës 12.13 dhe 16 .09.2019; Njoftim për pezullim të konkurseve të publikuara të datës 07.09.2019; Njoftimi i datës 8.10.2019; Konkursi i jashtëm i datë 22.03.2019; Përgjigje ne kërkesë e datës 26.02.2021; Vendim i datës 05.02.2019; E-mail i datës 11.01.2021; Sqarim i datës 27.01.2021; Vendim i datës 09.02.2021; Përgjigje e datës 26.02.2021 nr. Protokolli 843/2021 në ankesë nga Kryesuesi i Sekretariatit për pozita të larta drejtuese, në forme fizike; E-mail i datës 29.10.2020; E-mail i datës 11.02.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë është bërë i pamundur apo i kotë andaj edhe mbi këtë bazë ligjore kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse,**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me numër nr.0007/2021 i datës 11.01.2021, mbi pezullimin parandalues është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi Nr.06/L-114 të Zyrtarëve Publik përkatësisht me nenin 48 paragrafi 6 dhe nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores 12/2020 për Disiplinë dhe Ankesa të Zyrtarëve Publik, duke propozuar aprovimin e ankesës dhe shfuqizimin e vendimit te goditur me ankesë.

Në përgjigjen në ankesë me datë 26.02.2021, Sekretariati për Pozita të larta Drejtuese përkatësisht Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ka përcjell se bashku me shkresat e lëndës edhe Vendimin me numër protokollit 0024/10 të datës 29.01.2021 të protokolluar më datë 09/02/2021, me të cilin është shfuqizuar Vendimi me numër nr.0007/2021 të datës 11.01.2021 i kundërshtuar sipas kësaj ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 104 ku është përcaktuar se : ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***, andaj ne kuptim te këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se procedura administrative e iniciuar nga ankuesi përmes ankesës me numër A.nr.68/2021 të parashtruar me datë 08.02.2021 është bërë i pamundur, respektivisht vendimi i goditur me ankesë është shfuqizuar dhe si i tillë nuk prodhon pasoja juridike ne raport me ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 97 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku shprehimisht thuhet se: ***“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ ...”***, që në rastin konkret procedura administrative e nisur kundër Vendimit me numër nr.0007/2021 të datës 11.01.2021, mbi pezullimin parandalues, ka përfunduar me nxjerrjen e Vendimit me numër protokollit 0024/10 të datës 29.01.2021 të protokolluar më datë 09/02/2021, të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të themeluar nga Qeveria e Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.68/2021,më datë 03.03.2021

Zyrtë Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryesuesit të Këshillit Shtetërorë për Vlerësim dhe Disiplinë,
- Kryesuesit të Sekretariatit për Pozitat e Larta Drejtuese/Këshillit Shtetërorë për Vlerësim dhe Disiplinë,
- Ministrin të Financave,
- Sekretarin të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave,
- Sekretarin të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave,
- Arkivit të KPMSHCK-së.